



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT TË SKS, PËRAFRIMIT DHE PROJEKTEVE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Shtator-Dhjetor, 2025)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	3
Kuadri strategjik.....	4
Ecuria e aktiviteteve statistikore.....	5
Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale.....	6
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike.....	7
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	9
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.....	10
Censet	12
Menaxhimi i Cilësisë.....	13
Aktivitete të tjera	14

HYRJE

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësisimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të Planit Vjetor të PSZ për vitin 2025, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 29/2025, datë 17.03.2025 “Për miratimin e Planit Vjetor 2025 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë, të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.

Raporti përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi:

- Kuadrin Strategjik
- Ecurinë e aktiviteteve statistikore
- Censet
- Menaxhimin e Cilësisë

Progres raporti Shtator-Dhjetor, 2025

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, agjencitë statistikore të Sistemit Kombëtar Statistikor: INSTAT, Banka e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Planit Vjetor 2025 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026.

Kuadri strategjik

Strategjia e zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor është pjesë integrale e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026. Planit Vjetor për zbatimin e PSZ-së parashikon edhe aktivitetet për arritjen e objektivave strategjike. Objektivat janë shoqëruar me treguesit respektivë të performancës.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e treguesve të matshëm në nivel 4 mujor, për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025.

Tabela 1. Ecuria 4 mujore e treguesve strategjike Shtator-Dhjetor, 2025

Objektivi	Treguesi	Vlera Maj-Gusht, 2025	Vlera Shtator-Dhjetor 2025	Vlera sipas Planit Vjetor 2025
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian	Numri i akteve të reja ligjore të përafuara me acquis (Sipas PKIE)	0	2	7
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel qarku dhe bashkie Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	8	4 897,000	21
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranura Evropiane dhe ndërkombëtare	Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	17	14	63

Objektivi strategjik 4	Numri i institucioneve			
Përfshirja e institucioneve	furnizuese me të	4	2	1
shërbës prodhues në	dhënës administrative			
Programin kombëtar të	mikro			
Statistikave Zyrtare	Numri i testave të			
	trajtimeve të	2	2	6
	organizimit sipas			
	INSTAT			
Objektivi strategjik 5				
Modernizimi i mëtejshëm i				
proceseve, metodave,	Numri i aktiviteteve			
produkteve dhe	statistikore tek të cilat	16	61	114
shërbimeve statistikore për	përdoren software			
të përmirësuar cilësinë,				
dorëzimin në kohë dhe				
eficencën në kosto të				
statistikave zyrtare				
Objektivi strategjik 6	Numri i referimeve			
Rritja e besimit të publikut	ndaj produkteve të			
në SKS dhe njohja e tij si	SKS-së në media,	1011 ²	6874	29000
strukturë institucionesh me	p.sh., në gazetat			
performancë të duhur dhe	ditore kryesore ose në			
profesionalisht të pavarur	televizione			

Ecuria e aktiviteteve statistikore

Në Planin e PSZ 2025, për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, është parashikuar:

- Grumbullimi i të dhënave për 88 Produkte - Grumbulluar në kohë 87 produkte
- Përpunimi i të dhënave për 103 produkte - Përpunuar në kohë 103 produkte
- Publikimi i të dhënave për 72 produkte - Realizuar në kohë 70 publikime

Gjatë kësaj periudhe parashikohet realizimi i 61 aktivitete statistikore për publikimin e 72 produkteve statistikore.

Ndarja e aktiviteteve dhe produkteve statistikore sipas agjencive statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: 48 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 52 produkteve statistikore statistikore - realizuar në kohë 51 produkte.

Banka e Shqipërisë: 9 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 17 produkteve statistikore - realizuar në kohë sipas Planit.

Ministria e Financave: 2 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 2 produkteve statistikore- realizuar në kohë sipas Planit.

² Për katërmujorin reference treguesi është llogaritur manualisht, jo me kompaninë e monitorimit, sic është vepruar në 4-mujorët e kaluar.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: 2 aktivitete Statistike - planifikuar publikimi i 1 produkti statistikor – Nuk është publikuar në kohë.

Për 4-mujorin referencë, rezulton që plani është realizuar në masën 99% në fazën e grumbullimit, 100 % në fazën e përpunimit, 99% në fazën e publikimit.

Në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 3 fazave: grumbullim, përpunim dhe publikim.

Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale

Statistikat sociale përfshijnë statistikatat e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe kimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse është INSTAT.

Tabela 2. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	11	11	
Përpunim	15	15	
Publikim	12	11	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 11 produkte statistikore:

- Për 2 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 1 CAPI; 1 PAPI
- Për 7 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative: 2 Mikro; 4 Makro; 1 Kombinuar (Makro+Mikro).
- Për 1 produkt të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vrojtim + Burim Administrativ) dhe të dhënat janë të Kombinuara (Mikro + Makro)

2. Faza e përpunimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë përpunuar të dhënat në kohë për 15 produkte statistikore.


3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë publikuar të dhënat në kohë për 11 produkte statistikore:

- Për 2 publikime të dhënat janë në nivel qarku
- Për 9 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Nuk janë publikuar në kohë të dhënat administrative të mbrotjtjes sociale, pasi u shqyrtua shtimi i treguesve të rinj me seri kohore 2023-2025, të cilët do të jenë pjesë e publikimit të ardhshëm.

Figura 1. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, për fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 2 produkte statistikore.

Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë statistikën makroekonomike, statistikën financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikën e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

Objektivi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Tabela 3. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	13	12	1
Përpunim	17	17	
Publikim	14	14	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 12 produkte statistikore:

- Për 2 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 2 CAPI;
- Për 1 produkt të dhënat janë marrë nga burimet administrative dhe janë të nivelit Makro.
- Për 5 produkte të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vrojtim+Burim Administrativ): 1 Mikro; 1 Makro; 3 Kombinuar (Mikro + Makro).
- Për 4 produkte të dhënat janë marrë nga burime si: Burim administrativ + Regjistër. Të dhënat janë të kombinuara (Mikro + Makro).

Nuk u grumbulluan të dhënat në kohë për *statistikat mbi lejet e ndërtimit të miratuara në Republikën e Shqipërisë*, T3, 2025, për shkak të mungesës së raportimit nga bashkia Durrës.

2. Faza e përpunimit të të dhënave


Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë përpunuar të dhënat në kohë për 17 produkte statistikore.

3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë publikuar të dhënat në kohë për 14 produkte statistikore:

- Për 1 publikim të dhënat janë në nivel bashkie
- Për 1 publikim të dhënat janë në nivel qarku
- Për 12 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Figura 2. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, për fushën e Statistikave Ekonomike janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 11 produkte statistikore.

*INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë mundësoi transmetimin për herë të parë për publikim të statistikave të qeverisë dhe tabelave të njoftimit të procedurës së deficitit të tejkaluar. Të dhënat u transmetuan me 31 Tetor 2025 me seri kohore 2021-2024.

Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

Objekti kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Tabela 4. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	62	62	
Përpunim	66	66	
Publikim	43	42	1

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 62 produkte statistikore:

- Për 32 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 11 PAPI; 21 CAPI
- Për 16 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative: 12 Mikro; 4 Makro;
- Për 8 produkte të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara dhe janë të nivelit Mikro
- Për 6 produkte të dhënat janë marrë nga burime si: Vrojt看 + Burim Administrativ + regjistër): 2 Mikro; 4 Makro.

2. Faza e përpunimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë përpunuar të dhënat në kohë për 66 produkte statistikore.


3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë publikuar të dhënat në kohë për 42 produkte statistikore:

- Për 4 publikime të dhënat janë në nivel rajoni
- Për 38 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Nuk u publikuan të dhënat në kohë për *statistikat e energjisë me frekuencë 3-mujore*, T1, 2025, për të cilat institucioni përgjegjës është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për shkak të qarkullimit të stafit të Sektorit të Bilancit të Energjisë të këtij institucioni.

Figura 3. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, për fushën e Statistikave Sektoriale janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 32 produkte statistikore.

Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain

Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikat e mjedisit dhe statistikat rajonale dhe gjeohapësinore.

Qëllimi kryesor i statistikave të Mjedisit dhe Multidomain është sigurimi i të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë i treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mjedisore dhe socio-ekonomike, monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave si dhe integrimin e informacionit statistikor dhe atij gjeohapsinor, me anë të të cilit synohet sigurimi i numrit më të madh të mundshëm të statistikave të gjeoreferuara në kohë dhe cilësi nga fusha të ndryshme të statistikave në një nivel territorial të detajuar.

Agjencia statistikore përgjegjëse është INSTAT.

Tabela 5. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	2	2	
Përpunim	5	5	
Publikim	3	3	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikore:

- Për 2 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative dhe të dhënat janë të nivelit Mikro

2. Faza e përpunimit të të dhënave


Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë përpunuar të dhënat në kohë për 5 produkte statistikore.

3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë publikuar të dhënat në kohë për 3 produkte statistikore:

- Për 3 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Figura 4. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, për fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 3 produkte statistikore.

Aktivitetet mbi Informacionin Statistikor rajonal dhe Gjeohapësinor

Aktivitetet e realizuara të GIS për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë si më poshtë :

- *Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistikore:*
 - Në lidhje me përditësimin e databazës së Censit vijon puna për editimin e të dhënave
 - Publikimi i *Story Map* mbi Turizmin;
 - Publikimi i *Dashboard-it* të Bashkive;
- *Ndërtimi i Regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave të Shqipërisë:*
 - Testimi dhe modifikimi i rregullave të cilësisë (Quality Rules) të Regjistrit;
 - Testimi i vazhdueshëm i aplikacionit *mobile* të regjistrit;
 - Përgatitja e *use-case* për eksportimin e të dhënave të Regjistrit (*export snapshot*);
 - Testimi dhe feedback për aplikacionin web të regjistrit;
 - Testimi i lidhjes së të dhënave të Sistemit të Adresave dhe të dhënave të Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave për dy bashki pilot Korçë dhe Selenicë
- *Klasifikimi statistikor i njësive territoriale:*
 - Teste për publikimin e popullsisë në nivel grid;
 - Teste për përgatitjen e Tipologjive Territoriale ("Territorial typologies" -> Cluster types)
- *Harmonizimi i temave "Demografia" dhe "Njësitë Statistikore" sipas direktivës INSPIRE:*
 - Testimi i popullsisë në nivel grid me të dhënat e Cens 2023;
 - Takime me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në kuadër Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore;
 - Publikimi i Popullsisë (Popullsia gjithsej) së Censit 2023 në nivel grid.

Censet

▪ Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, janë realizuar aktivitetet si vijojnë:

- Prodhimi i treguesve rajonalë me qëllim pasurimin e gjeo-databazës;
- Integrimi i të dhënave të gjeo-databazës në Px-Web;
- Finalizimi i analizave të thelluara tematike të Cens për:
 - Të rinjtë dhe fëmijët;
 - Romët dhe Egjiptianët;
 - Profili i personave me aftësi të kufizuara.
- Vlerësimi i projeksioneve të popullsisë bazuar në analizën e të dhënave të Censit 2023, nëpërmjet përditësimit të hipotezave sipas varianteve (i ulët, mesëm dhe i lartë) të komponentëve bazë (lindje, vdekje dhe migracion), mbështetur në trendet e tyre ndër vite.

▪ Censi i Bujqësisë

Gjatë periudhës Shtator-Dhjetor, 2025, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Organizimi i misionit mbi pyetësin e Cens-it të Bujqësisë, në datat 02-05 Dhjetor 2025, me stafin e Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në misionin e ekspertës Irena Orešnik.

- Përditësimi i pyetësorit duke u bazuar në diskutimet gjatë misionit dhe rekomandimet e lëna nga ekspertja në raportin e misionit.
- Organizimi i punës për përmbushjen e detyrave të lëna nga ekspertja në raportin e misionit dhe fillimi i punës për përkthimin në shqip të pyetësorit.
- Përkthimi i variablave me vlerësimin e përputhshmërisë me rregulloren zbatuese të BE, nr. 2024/2914 mbi Statistikat e Integruara të Fermave, për vitin e referencës 2026.
- Vlerësimi i përputhshmërisë dhe korrespondencës përkatëse të pyetjeve në pyetësor me variablat në rregulloren zbatuese të BE, nr. 2024/2914 mbi Statistikat e Integruara të Fermave, për vitin e referencës 2026.
- Ndjekja e takimeve dhe vlerësimi i komenteve të ardhura nga Institucionet dhe OJF për projekt-ligjin e Censit të Bujqësisë.
- Digjitalizimi i pyetësorit dhe përgatitja e instrumenteve të mbledhjes së të dhënave në formatin elektronik CAPI (Computer Assisted Personal Interviewing).
- Identifikimi dhe inventarizimi i burimeve statistikore dhe administrative relevante, standardizimi i variablave kryesore dhe ndërtimin e një strukture të unifikuar databaze, që do të shërbejë si bazë për krijimin e frame-it final të Censit të Bujqësisë.
- Përgatitja e draftit të shpërndarjes së Njësive Ekonomike Bujqësore të dala nga Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023.

Menaxhimi i Cilësisë

Gjatë periudhës **Shtator-Dhjetor, 2025**, vlerat e treguesve të cilësisë janë reflektuar në tabelat sipas fushave statistikore si më poshtë:

Tabela 6. Statistikat Sociale dhe Demografike: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2025	Shtator- Dhjetor, 2025
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	17	0
Matja e kostos së aktiviteteve statistikore	17	0
Auditi Statistikor	1	0
Pyetësori i vetëvlerësimit	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	21	5
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja	2	0

Tabela 7. Statistikat Ekonomike: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2025	Shtator- Dhjetor, 2025
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	17	0
Matja e kostos së aktiviteteve statistikore	17	0
Auditi Statistikor	1	0
Pyetësori i vetëvlerësimit	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	17	1

Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja	0	0
---	---	---

Tabela 8. Statistikat Sektoriale: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2025	Shtator- Dhjetor, 2025
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	24	0
Matja e kostos së aktiviteve statistikore	24	0
Auditi Statistikor	0	0
Pyetësi i vetëvlerësimit	2	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	18	6
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja	0	0

Tabela 9. Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2025	Shtator- Dhjetor, 2025
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	4	0
Matja e kostos së aktiviteve statistikore	4	0
Auditi Statistikor	0	0
Pyetësi i vetëvlerësimit	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	7	2
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja	~	0

Aktivitete të tjera

Konferenca “Dita Botërore dhe Evropiane e Statistikave: Statistika të Besueshme për Anëtarësimin në BE”

Me rastin e Ditës Botërore dhe Evropiane të Statistikave, Instituti i Statistikave (INSTAT) organizoi më 20 Tetor 2025, Konferencën me temë “Statistika të Besueshme për Anëtarësimin në BE – Përparimi i Shqipërisë në Kapitullin 18: Statistikat drejt Integritimit Evropian.”

Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe mblodhi së bashku përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, të botës akademike, mediae, studentëve dhe aktorë të rëndësishëm të fushës së statistikave.

Në fjalën e hapjes, znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm në atë periudhë, theksoi rëndësinë e kësaj dite si një moment reflektimi për rolin e statistikave zyrtare në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian:

Në vijim, mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse Sh.S. znj. Ruth Huber, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri, z. Adrian Kamenica, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të Politikës dhe Integritimit

Evropian në Kryeministri dhe znj. Ritva Heikkinen, Shefe e Bashkëpunimit të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Pjesë e rëndësishme e Konferencës ishte diskutimi i hapur me panelistët znj. Milva Ekonomi, Kryetare e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, znj. Argita Frashëri, Drejtor i Departamentit të Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Prof. Asoc. Dr. Bernard Dosti, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Në vijim të aktivitetit, u mbajtën dy prezantimet me tema kryesore “Kapitulli 18 – Statistikat: Rruga drejt Anëtarësimit”, nga znj. Vjollca Simoni, Drejtor i Drejtorisë së Integritit Evropian dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë INSTAT dhe prezantimi “INSTAT GeoData Hub / WebGIS Platforma”, nga znj. Helda Mitre, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave në INSTAT.

Dita Botërore dhe Evropiane e Statistikave është një iniciativë ndërkombëtare që synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin kyç të statistikave të besueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe në ndërtimin e politikave të bazuara në fakte.

Takimi i Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare

Më 27 Tetor 2025, INSTAT, si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor, organizoi takimin e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Pjesëmarrës në këtë takim ishin anëtarët e Komitetit: Znj Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT në atë periudhë, Znj Natasha Ahmetaj, Zv. Guvernatore e Bankës së Shqipërisë, Z. Endrit Yzeiraj, Z. Ministër i Financave dhe Z. Erlind Sulo, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Në mbledhje ishin të pranishëm edhe stafet eksperte të institucioneve respektive.

Takimi i Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe veprimtarisë koordinuese mes institucioneve pjesë të Sistemit Kombëtar Statistikor. Temat e diskutimit ishin kryesisht të natyrës informative, duke synuar njohjen e anëtarëve të Komitetit mbi punën përgatitore në lidhje me Projekt-Programin e Statistikave Zyrtare 2027 -2031. Ky Program do të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare dhe vendosjen e prioritetëve në çështjet e prodhimit statistikor. Në zbatim të këtij Programi prodhuesit e statistikave zyrtare do të fokusohen në prodhimin e treguesve statistikorë sipas kërkesave të përdoruesve dhe kërkesave të Eurostatit në kuadër të integritit evropian.

INSTAT informoi gjithashtu mbi përgatitjet që duhet të ndërmarrin institucionet anëtare të komitetit për ushtrimin e vlerësimit të “Peer Review 2026”. Misioni i Peer Review do të kryhet nga Eurostat në Mars 2026 dhe ka për qëllim të vlerësojë funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe zbatimin e parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane, të përafuara me Ligjin nr. 17/20218 “Për statistikat zyrtare”.

Po ashtu, pjesë e diskutimit në këtë takim ishte koordinimi i punës mbi forcimin e Statistikave Makroekonomike ndërmjet INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave me qëllim rritjen e koherencës dhe harmonizimit të të dhënave të kësaj fushe, sipas kërkesave dhe parashikimeve në *closing benchmark* mbi dorëzimin në kohë dhe me cilësi të tabelave të llogarive kombëtare në Eurostat.

Takimi Hapës i Projektit “Statistikat shqiptare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BE-së”

Më 26 Nëntor, 2025, INSTAT mori pjesë në takimin zyrtar hapës të projektit “Statistikat shqiptare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BE-së”, një iniciativë dhe bashkëpunim i rëndësishëm me Ambasadën Suedeze në Shqipëri dhe zyrën statistikore të Suedisë. Ky bashkëpunim synon të forcojë Sistemin Kombëtar Statistikor dhe avancimin e progresit të Shqipërisë drejt integritetit evropian. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë, partnerëve dhe aktorëve të rëndësishëm të komunitetit statistikor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Fjalën hyrëse e mbajti Sekretari i Përgjithshëm i INSTAT, z. Alban Çela, për të vijuar me fjalët përshëndetëse nga z. Niklas Ström, Ambasador i Suedisë në Shqipëri, znj. Eva-Lo Ighe, Drejtor i Përgjithshëm i Statistikave të Suedisë, znj. Blerta Rama, Zv. Ministre e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Takimi vazhdoi me prezantimet e z. Maldy Dema, Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit të SKS-së, Përafrimit dhe Projekteve, lidhur me punën e kryer nga INSTAT sa i takon zhvillimit të Sistemit Statistikor Kombëtar dhe sfidat që na presin përpara.

Po ashtu znj. Birgitta Mannfelt, Këshilltare Afatgjatë (nga Statistikat e Suedisë), rezidente në Shqipëri, solli një prezantim përmbledhës të projektit dhe të bashkëpunimit me INSTAT.

Gjithashtu, sot u firmos Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT dhe Statistikave Suedeze për zbatimin e këtij projekti të përbashkët, me synim rritjen e kapaciteteve të INSTAT për përmbushjen e detyrave të tij si dhe kërkesave të acquis të BE-së në fushën e statistikave.

Përafrimi i statistikave zyrtare shqiptare me acquis të BE-së mbetet një prioritet për INSTAT. Gjatë viteve të fundit është arritur përparim i dukshëm në përmirësimin e cilësisë së të dhënave, forcimin e metodologjisë, digjitalizimin e proceseve të prodhimit dhe rritjen e bashkëpunimit brenda Sistemit Statistikor Kombëtar. Kjo fazë e bashkëpunimit me Statistikat e Suedisë do të mbështesë më tej Shqipërinë në përmbushjen e standardeve të Sistemit Evropian Statistikor, duke siguruar krahasueshmëri, besueshmëri dhe transparencë të statistikave zyrtare.

Leksion i hapur në universitetin “Eqrem Qabej”, Gjirokastrë

Më 11 Dhjetor, 2025, INSTAT zhvilloi një leksion të hapur në Universitetin “Eqrem Qabej” të Gjirokastrës, në kuadër të nismës së INSTAT për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e statistikave zyrtare përmes edukimit statistikor.

Gjatë këtij leksioni studentët dhe stafi pedagogjik u njohën më nga afër me:

- Sistemin Kombëtar Statistikor
- Programin e Statistikave Zyrtare
- Procesin e Integritetit në BE
- Aktivitetet e INSTAT në kuadër të edukimit statistikor
- Platformën e GjeodataHUB

Në aktivitet morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm në atë periudhë, znj. Elsa Dhuli, Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të SKS, Përafrimit dhe Projekteve, z. Maldi Dema, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave znj. Helda Mitre, Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve, z. Altin Xhikneli, Drejtori i Drejtorisë së Popullsisë dhe Statistikave Sociale, znj. Anisa Omuri.

Qëllimi i aktivitetit ishte afrimi i të rinjve me statistikat, duke i ndihmuar të kuptojnë rolin që kanë statistikat zyrtare në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Eventi mbi Anketën e Migracionit pranë Familjeve dhe Studimin Cilësor mbi Migracionin

INSTAT, Banka Botërore, IOM dhe GIZ prezantuan më 15 Dhjetor, 2025, gjetjet e Anketës së dytë të Migracionit pranë Familjeve (Household Migration Survey – HMS) dhe të Studimit Cilësor Plotësues “Sfidat dhe Mundësitë në Integrimin e të Kthyerve dhe Angazhimin e Diasporës në Shqipëri”, duke forcuar më tej të dhënat kombëtare mbi dinamikën e migracionit, modelet e lëvizshmërisë dhe lidhjet me zhvillimin e vendit.

Eventi i prezantimit mbledhi së bashku Institutin e Statistikave (INSTAT), Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Bankën Botërore, si dhe përfaqësues nga institucionet kombëtare, bashkitë, partnerët për zhvillim, akademia, shoqëria civile dhe media.

E udhëhequr nga INSTAT dhe Banka Botërore, Anketa e Migracionit pranë Familjeve ofron të dhëna përfaqësuese në nivel kombëtar mbi tendencat e migracionit, kthimin, remitancat dhe lëvizshmërinë në nivel familjar.

Sipas rezultateve, rreth 37% e familjeve shqiptare kanë të paktën një anëtar që ka migruar, qoftë aktualisht jashtë vendit apo i kthyer nga emigracioni. Rreth 22% e familjeve kanë anëtarë aktualisht jashtë Shqipërisë, ndërsa 20% kanë të paktën një migrant të kthyer.

Në plotësim të Anketës, Studimi Cilësor i udhëhequr nga IOM në bashkëpunim me GIZ, analizon se si migracioni, kthimi dhe angazhimi i diasporës, përjetohen dhe menaxhohen nga individët, familjet, autoritetet vendore dhe institucionet në mbarë vendin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado

